



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**PROCESVERBAL**

**Tiranë, më 29.09.2022, ora 14.00**

**Drejton mbledhjen Sokol Binaj – Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

**Rendi i Ditës:**

- 1. Mbi ndërprerjen e procedurave të verifikimit të kushteve ligjore për kandidaten Juliana Latifi në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë (relatore M. Xhaferllari);*
- 2. Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur në datën 16.01.2017 rishpallur në datat 03.06.2021 dhe 31.01.2022.*
- 3. Të tjera.”*

**Marrin pjesë:**

- |                          |                      |
|--------------------------|----------------------|
| 1. Sokol Binaj           | (kryetar)            |
| 2. Marsida Xhaferllari   | (zëvendës kryetare)  |
| 3. Anila Leka            | (anëtare)            |
| 4. Elsa Toska            | (anëtare)            |
| 5. Edlira Petri          | (anëtare)            |
| 6. Klodiana Mema (Veizi) | (anëtare)            |
| 7. Etien Kapo            | (anëtar)             |
| 8. Enton Dhimitri        | (anëtar)             |
| 9. Sandër Simoni         | (anëtar zëvendësues) |
| 10. Altin Binaj          | (anëtar zëvendësues) |

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:**

1. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit dhe Kuvendit, nuk janë të pranishëm.
2. Përfaqësues i Delegacionit të BE-së, nuk është i pranishëm.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:**

1. **Alket Jaupi** dhe **Alma Sina** - Përfaqësues me autorizim të Presidentit të Republikës.

Me pjesëmarrjen e përfaqësues se OPDAT, këshilltarja ligjore **Zj. Blerina Fani**

**HAPET MBLEDHJA: ora 14.09**

**Kryetari Sokol Binaj** – Çelim mbledhjen e caktuar për ditën e sotme të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me rend dite “Konstatimin e formës së prerë të vendimmarrjes së këtij Këshilli lidhur me ndalimin e kandidaturës së kandidatës Juliana Latifi, në vakancën e Gjykatës së Lartë, për të kandiduar anëtare e Gjykatës Kushtetuese, në kushtet e verifikimit të mosparaqitjes së ankimit

nga ana e saj dhe për konsekuencë pastaj në funksion të këtij verifikimi edhe procedimi lidhur me vazhdimin e mëtejshëm të trajtimit të kësaj vakance.

Verifikojmë pjesëmarrjen e anëtarëve të pranishëm.

E pranishme zonja Xhaferllari, zonja Toska, zonja Leka, zonja Petri, zonja Mema, Zoti Kapo, zoti Dhimitri, për Presidencën të pranishëm përfaqësuesit e Presidentit zoti Jaupi dhe zonja Sina, është e pranishme për OPDAT-in, këshilltarja ligjore pranë OPDAT-it, zonja Blerina Fani, nuk janë të pranishëm përfaqësuesit e Kuvendit dhe Avokatit të Popullit, të cilët kanë njoftuar të dy bashkë ndodhen në një shërbim jashtë shtetit, në pamundësi për të marrë pjesë. Janë të pranishëm edhe anëtarët zëvendësues zoti Binaj dhe zoti Simoni.

**Sokol Binaj** – Atëherë vazhdojmë direkt pa u vonuar me relatimin e zonjës Xhaferllari.

**Marsida Xhaferllari** – Faleminderit Zoti Kryetar. Lexon në mënyrë të përmbledhur relacionin e përgatitur.

**Sokol Binaj** – Faleminderit atëherë. Ndonjë diskutim lidhur me problematikën që del?

**Elsa Toska** – Faleminderit Kryetar. Unë nuk është se kam ndonjë diskutim të madh por vetëm siç po e thosha dhe pak më përpara jashtë regjistrimit audio të mbledhjes lidhur me rendin e ditës, normalisht ne nuk besoj që jemi përpara ndërprerjes së procedurave ashtu siç u tha edhe këtu verbalisht qoftë ju qoftë relatorja, jemi para konstatimit të faktit që kanë mbaruar afatet e ankimit dhe që një nga kandidatët ka hequr dorë nga e drejta e ankimit, kështu që jemi përpara këtij fakti, që nuk kemi se çfarë të presim. Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, edhe për këtë kam një lloj komenti domethënë, mendoj që t'i qëndrojmë strikt pikës 32 të vendimit nr. 4 të KED-it, ne nuk pezullojmë procedurën dhe njoftojmë subjektin për të vlerësuar rishpalljen, por pezullojmë procedurën dhe njoftojmë subjektin në mënyrë që ai të vendosi në mënyrën se si do vazhdojmë me tutje me pozicionin vakant. Kështu që...

**Sokol Binaj** – Faleminderit! Lidhur me diskutimin kryesisht të pikës së dytë që ngriti dhe Elsa, lidhur me momentin e njoftimit të subjektit lidhur me situatën aktuale të verifikuar në këtë vakancë, Zonja Leka?

**Anila Leka** - Përsa u diskutua nga anëtarja Marsida, nuk kam dika për të diskutuar, përderisa ka rënë numri i kandidaturave, jam dakord që nuk ngelet gjë tjetër veçse të njoftohen subjektet që e kanë vënë në lëvizje KED-në, që të vlerësojnë situatën, janë njoftuar, por lidhur me pezullimet, unë vetëm thjesht jam në kujtesë që duhet të kemi parasysh ajo që ka ndodhur me listat e bashkuara për vendin vakant të Zotit Gani Dizdari, porblematika që na doli ne si KED, për procedurën e verifikimit të kryer ndaj tij kandidati, iu bashkëlidhën listës. Afati i procedurës mbaj mend, kur do fillojë procedura e verifikimit, cila datë do konsiderohet ajo kur i është ndërprerë apo që i është filluar kandidatëve nga listat e mëpërashme apo ajo e kandidatëve që do ju bashkëlidhen.

*Flasin pa mikrofon*

**Sokol Binaj** – Faleminderit! Zonja Petri?

**Edlira Petri** – Edhe unë jam dakord për pezullimin e procedurës, nuk shof që mund të marim një vendim tjetër pavarësisht shqetësimit që ngre zonja Leka, sepse nuk mund t'i japim fund procedurës, nuk mund t'i japim fund përsa kohë që varet nga vlerësimi që do të bëjë Gjykata e



Lartë, në lidhje me këtë proces, kështu që më duket që i vetmi vendim që mund të marrim është ky pra, ta pezullojmë. Më pas të zgjidhet në eventualitet asaj që do të ndodhë, nuk është se nuk është e pariparueshme edhe nëse do të lind nevoja për shkak të afateve do të zgjidhet qoftë nga ne qoftë nga KED-ja tjetër.

**Anila Leka-** Jo thjesht ashtu si u diskutua më para, duhet të kem parasysh procedurën që bëhet tani për plotësimin e deklaratës që është online dhe palët gjithmonë, kandidatët, ato janë të detyruar ta bëjnë si fillestar. Unë e kuptoj në thelb, por gjithmonë pasur bazë diskutimi për barazinë e palëve, unë e kuptoj që keq është t'iu thuash ashtu, por edhe keq është të rideklarojnë nga e para, njësoj do të bëhet

**Edlira Petri** – Po, por atëherë cila do ishte një zgjidhje alternative?

**Anila Leka** – Po, prandaj po e diskutoja me anëtarin që vjen nga Gjykata Administrative, se di që mbajmë një qëndrim por dhe kujtesa bën të vetën, kështu që thjesht (nuk dëgjohet mirë). *Flet pa mikrofon*

**Sokol Binaj** – Zoti Dhimitri?

**Enton Dhimitri** – Atëherë dakord me propozimin e relatores për pezullimin e procedurave, është standart i vendosur nga KED-i dhe të respektohet, nuk ka ndonjë gjë.

**Elsa Toska** – Për ndërprerjen e procedurave?

**Enton Dhimitri** – Për pezullimin e procedurave.

**Elsa Toska** – Për pikën e dytë atëherë flasim. Po për pjesën e dytë, më falni se është rendi i ditës ka dy pjesë pra, propozova rikorigjimin e pjesës së dytë, pra si i drejtohem Gjykatës së Lartë, për të vlerësuar rishpallje apo i drejtohem Gjykatës së Lartë për të vendosur mënyrën e procedimit të mëtejshëm?

**Enton Dhimitri** – Rishpalljen.

*Flitet njëkohësisht pa mikrofon*

**Sokol Binaj** – Zoti Kapo?

**Etien Kapo** – Edhe unë përta i përket pikës së parë jemi dakord, po qe se është bërë si praktikë të vendoset pezullimi. Përta i përket pikës së dytë të rendit të ditës, them se duhet konstatuar nga ana jonë dhe më pas t'i njoftohet organit të emërtesës për vlerësimin e saj, nëse, çfarë procedure do të ndjekim më pas.

**Sokol Binaj** – Faleminderit! Zonja Mema?

**Klodiana Mema (Veizi)** – Atëherë përta i takon gjithë pikës së dytë të rendit të ditës, vendimi i KED, në pikën 32 të tij ka parashikuar që rastet kur numri i kandidaturave për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese, s'bëhet më pak se tre, njofton kryetarin i cili thërret mbledhjen e Këshillit për të vendosur në mënyrën e procedimit. Idea është që këshilli, do vendosi që t'i drejtohet Gjykatës së Lartë, për ta rihapur pa pyetur ata apo pa pyetur që a do shpreh vullnetin e vetë dhe në këtë rast s'ka nevojë që të bëhet as pezullim as... përveçse të konsiderohet e përfunduar kjo si procedurë ose në të kundërt do të votojmë pastaj që t'i drejtohem Gjykatës së

Lartë dhe të pyesim nëse Organi i Emërtesës do të vazhdojë plotësimin e vakancës me dy kandidatët e mbetur apo jo, nëse mendimi është që Këshilli t'i drejtohet Gjykatës së Lartë që kjo të japë mendimin e saj lidhur me faktin se do të vijojë apo jo plotësimin e vakancës, mendoj që duke i lënë një afat të shkurtër, për të shprehur mendimin e saj shmangim dhe këtë pezullimin e procedurës, nuk ka nevojë të shprehemi për pezullim sepse pezullimi pastaj të fut në ato frikërat që ka Anila, përse i përket kandidatëve që janë në garë, dy kandidatëve të mbetur në garë dhe dilemave që mund të lindin, për të dalë nga një procedurë e rifilluar pas pezullimit, pra duke i lënë Gjykatës së Lartë një afat të shkurtër për t'u shprehur sepse nuk ka ndonjë gjë të madhe për të vepruar dhe ne i mënjanojmë edhe këto shprehjet pezullim apo ku di unë...dhe mblidhemi përsëri, paraqesim këtë qëndrimin që do të mbajë Organi i Emërtesës dhe marim vendimin pastaj për përfundimin e procedurës apo vijimin e saj me dy kandidatët e mbetur në garë, ky është mendimi im.

**Sokol Binaj** – Faleminderit! Dakord jam edhe unë, njoftimin e Gjykatës së Lartë, lidhur me situatën e verifikuar aktualisht, të rënies së numrit nga 3 në 2 të kandidatëve në funksion të procesit të verifikimit, në mënyrë që Gjykata e Lartë të procedojë për vazhdimin e mëtejshëm të kësaj procedure verifikimi.

**Sokol Binaj** – Zoti Jaupi?

**Alket Jaupi** – Faleminderit Zoti Kryetar! Sikurse doli edhe nga diskutimi i anëtarëve të tjerë se precedenti ekziston, pra nëse numri i kandidatëve zbret poshtë treshit, humbet edhe përcaktimi ligjor për mënyrën se si do të drejtohem për vazhdimësinë e mëtejshëm të procesit, ajo që për ne është esenciale në kuptimin procedural, është që duhet të ketë një njoftim paraprak Organit të Emërtesës. Vendimmarrja në lidhje me mënyrën e procedimit nga ana e KED-së në rastin konkret, nëse vazhdon procedura si normale apo pezullohet, është çështje e KED-së, përse i përket afateve të vlerësimit si të vlefshëm të atij deklarami që është bërë me kandidatët pranë ILDKPKI-së, unë do të tërhiqja vëmendjen për t'i pasur parasysh këto afate dhe për të konsideruar njoftimin thjesht në mënyrë të drejtpërdrejtë të Organit të Emërtesës në këtë rast apo pezullimin si procedurë për të vazhduar më tej për rihapjen apo rishpalljen nëse Organi i Emërtesës do të vendosë për një gjë të tillë. Ky është një mendim që unë doja të ndaloja, mos harrojmë që ka pasur dhe raste që Organi i Emërtesës, megjithëse ka pasur dy kandidatë, e ka cilësuar si të vlefshme këtë procedurë dhe ka vazhduar më tej,

**Sokol Binaj** – Po, ka vijuar vazhdimin.

**Alket Jaupi** - Po, është rasti i Presidentit të Republikës dhe i Kuvendit njëkohësisht. Faleminderit!

**Sokol Binaj** – Faleminderit! Zonja Sina?

**Alma Sina** – Nuk kam gjë për të shtuar.

**Sokol Binaj** – Faleminderit! Zonja Fani, keni ndonjë opinion?

**Blerina Fani** – Jo! Faleminderit.

**Sokol Binaj** – Faleminderit! Mirë atëherë, tërhiqemi për të vendosur në Dhomë Këshillimi, lidhur me problematikën e trajtuar? Jeni gati? Në rregull!

**Këshilli tërhiqet për vendim.**



Këshilli pasi u kthye, pasqyron prezencën e zonjës Arbi, e cila u paraqit në këto momente si përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë,

### **VENDOSI**

Mbledhja konstatoi formën përfundimtare të konkluzionit të saj lidhur me ndalimin e kandidimit të kandidatës Latifi në vakancën e shpallur nga Gjykata e Lartë, për anëtare në Gjykatën Kushtetuese, në vakancën e Zonjës Tushe, në këto kushte të verifikimit të formës përfundimtare të këtij vendimi përsa kohë që kandidatja nuk ka paraqitur ankim, në Gjykatën Administrative, lidhur me këtë vendim konstatohet situata që në këtë vakancë mbeten si aplikantë konkurentë për këtë pozicion vetëm dy kandidatë, gjë që na obligon që në mënyrë të detyrueshme të vëmë në dijeni Organin e Emërtesës, Gjykatën e Lartë, lidhur me këtë situatë të krijuar të pamundësisë për të proceduar më tej në kushtet kur aplikantë mbeten vetëm 2. Pra njoftohet Gjykata e Lartë menjëherë lidhur me këtë situatë, në mënyrë që të marri rrugë edhe vazhdimi i mëtejshëm i procedurës së verifikimit në këtë vakancë.

**Ky ishte vendimi, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.**

**Tiranë më datë 29.09.2022**

**KRYETAR**

**Sokol BINAJ**

